

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT



Donika Koliqi

**IDENTIFIKIMI I QËNDRIMEVE TË MËSIMDHËNËSVE NDAJ  
EDUKIMIT GJITHËPËRFSHIRËS DHE I FAKTORËVE QË  
NDIKOJNË NË FORMIMIN E TYRE**

**REZYME E PUNIMIT TË DOKTORATËS**

Prishtinë, 2022

## Rezyme

Gjithëpërfshirja është një reformë arsimore e vazhdueshme, që promovon politikat bazuar mbi të drejta, siguron mirëqenjen dhe ofron “akomodim, adaptim dhe mbështetje” (EADSE, 2017) intensive për të gjithë fëmijët/nxënësit. Ajo është një nga sfidat e arsimit bashkëkohor, për jetësimin e të cilit rol të veçantë kanë qëndrimet e mësimdhënësve ndaj konceptit dhe praktikave gjithëpërfshirëse (Avramidis & Norwich, 2002. Boyle, Topping, & Jindal-Snape, 2013; Saloviita & Schaffus, 2016; Ainscow, 2020; Saloviita 2020; Parey, 2021). Mbështetur në rëndësinë e qëndrimeve të mësimdhënësve, kjo tezë e doktoratës ka si qëllim identifikimin e qëndrimeve të mësimdhënësve kosovarë të nivelit arsimor parauniversitar ndaj edukimit gjithëpërfshirës, si dhe eksplorimin e faktorëve që ndikojnë në formimin e këtyre qëndrimeve, përfshirë: gjininë, moshën, vendbanimin, përgatitjen profesionale, nivelin arsimor, trajnimet për edukim gjithëpërfshirës, përvojën arsimore, përvojën e punës me fëmijë me nevoja të veçanta, si dhe vetefikasitetin e mësimdhënësve për praktikën gjithëpërfshirëse. Për të ofruar informata më të hollësishme janë eksploruar edhe përvojat e mësimdhënësve, me theks të veçantë sfidat dhe nevojave të tyre në realizimin e gjithëpërfshirjes në mjedise mësimore.

Nga aspekti teorik studimi mbështetet në teorinë e qëndrimeve sociale të Rosenberg dhe Hovland (1960), në teorinë e social-kognitive të Bandurës (1977), si dhe në atë social-kulturore të Vigotskit.

Hulumtimi u realizua me metoda mikse (sasiore e cilësore). Pjesë e hulumtimit sasiore janë 1085 respondentë nga shtatë rajonet kryesore të Kosovës, të cilët janë përzgjedhur me teknikën e thjeshtë rastësore. Për mbledhjen e të dhënave sasiore janë përdorur dy instrumente të standardizuara, siç janë: “Shkalla e qëndrimit të mësuesit ndaj arsimit gjithëpërfshirës” (Saloviita, 2015) për të evidentuar gatishmërinë intelektuale të mësimdhënësve, dhe “Efikasiteti i mësuesve për praktikën gjithëpërfshirëse” (Sharma, Loreman & Forlin, 2012) për të pasqyruar vetefikasitetin e mësimdhënësve për praktikën gjithëpërfshirëse. Të dhënat janë analizuar me statistikat përshkruese, korrelative dhe të regresion të shumëfishtë.

Pjesa kualitative e hulumtimit mbështetet në dizajnin fenomenologjik. Mostra është përfaqësuar me 10 mësimdhënës, përkatësisht dy mësimdhënës nga niveli arsimor parashkollor, dy nga niveli parafillor, dy nga niveli fillor, dy nga niveli i mesëm i ulët dhe dy nga ai i lartë. Strategjia e përzgjedhjes së mostrës për hulumtimin kualitativ është e qëllimshme dhe tipi i përzgjedhjes së

mostrës është teknika zinxhir. Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave të thella gjysmë të strukturuar dhe janë analizuar përmes analizës tematike. Për të mundësuar përfundime më përfshirëse, më të plota dhe më të hollësishme për qëndrimet e mësimit dhe perceptimet e tyre ndaj zbatimit të arsimit gjithëpërfshirës janë realizuar metakonkluzionet.

Rezultatet tregojnë qëndrime pozitive të mësimit kosovarë ndaj edukimit gjithëpërfshirës. Këtë praktikë e kuptojnë si të drejtë e mbrojtur me ligj dhe si detyrim moral e human, dhe si mundësi për përfshirje aktive në komunitet. Rezultatet e hulumtimit nuk kanë dëshmuar për dallime të rëndësishme midis qëndrimeve të mësimit të gjinive të ndryshme, mirëpo një dallim i rëndësishëm u identifikua në nënshkallën “të drejtat e fëmijës”, ku mësimit e gjinisë femërore arritën mesataren më të lartë. Të gjeturat nuk treguan dallime midis qëndrimeve të mësimit varësisht nga vendbanimi në zonë urbane apo rurale, por ato dëshmuar për dallime midis mësimit të rajoneve të ndryshme, ku rajoni i Pejës tregoi mesataren më të lartë. Qëndrime më pozitive kishin mësuesit në moshë të mesme 42-57 vjeç, ata me përvojë të punës nga 11 deri në 15 vite, ata me më tepër se katër vite përvojë të punës me nxënës me nevoja të veçanta, ata nga niveli i mesëm i lart, si dhe me më tepër se tri trajnime. Hulumtimi nuk rezultoi me dallime midis mësimit, varësisht nga kualifikimi arsimor i tyre. Ndërlidhje lineare pozitive u dëshmuar midis qëndrimeve të mësimit ndaj edukimit gjithëpërfshirës me moshën dhe me përvojën profesionale të tyre, ndërsa nuk u dëshmuar ndonjë ndërlidhje midis qëndrimeve përkatëse me kualifikimin arsimor. Korrelacion negativ u identifikua midis qëndrimeve të mësimit me përvojën e punës së tyre me nxënës me nevoja të veçanta, si dhe nuk u gjet ndonjë lidhje me trajnimet e mësimit për edukimit gjithëpërfshirës. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim treguan vetefikasitet të lartë për praktikën gjithëpërfshirëse, veçanërisht për udhëzimet përfshirëse. Korrelacion pozitiv u identifikua midis qëndrimeve të mësimit dhe vetefikasitetit të tyre për praktikën gjithëpërfshirëse. Sipas testit të regresionit të shumëfishtë i tetë faktorëve që mund të parashikojnë vlerën e qëndrimeve të mësimit ndaj edukimit gjithëpërfshirës, rezultoj se vetëm moshë, rajoni, niveli arsimor, përvoja e punës me fëmijë me nevoja të veçanta dhe vetefikasiteti parashikojnë në mënyrë të konsiderueshme qëndrimet e tyre. Ndërsa, parashikuesi më i mirë i qëndrimeve të mësimit ishte vetefikasiteti i tyre për praktikën gjithëpërfshirëse.

Mësuesit besojnë që nuk janë të përgatitur të punojnë me nxënës me nevoja të veçanta të rënda. Ata ballafaqohen me disa vështirësi: vetëdijësimi i ulët shoqëror, mungesa e aftësive profesionale, mungesa e informacioneve, mungesa e trajnimeve, mungesa e mbështetjes humane dhe fizike, lloji dhe shkalla e dëmtimit, mungesa e kohës, mbingarkesa e punës, ndjenja e stresit dhe ankthit. Ata shtrojnë nevojën për mbështetje nga Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe institucioni përkatës shkollor, sidomos për staf profesional mbështetës, për trajnime, për materiale, mjete, infrastrukturë, por edhe për mbështetje nga familja dhe komuniteti në tërësi. Në funksion të efikasitetit dhe cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës, krahas qëndrimeve të mësimdhënësve dhe nevojave të tyre, është e rëndësishme të identifikon disa nga komponentët kryesorë që mund të përmirësojnë praktikën gjithëpërfshirëse, siç janë: identifikimi i hershëm dhe vlerësimi i aftësive dhe nevojave të fëmijës; bindjet dhe qëndrimet pozitive ndaj gjithëpërfshirje; sigurimi i barazisë dhe cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies; të kuptuarit e përfitimeve të mjediseve gjithëpërfshirëse; kurrikula holistike dhe fleksibile; përgatitja profesionale dhe zhvillim profesional i mësimdhënësve; zhvillimi i kulturës, politikave dhe praktikave pozitive gjithëpërfshirëse; mbështetja në nivel qendror, komunal dhe institucional; mbështetja fizike, njerëzore dhe financiare; bashkëpunimi dhe komunikimi shkollë, familje dhe komunitet; qasja me në qendër fëmijën dhe vlerësimi i personalizuar; monitorimi, vlerësimi dhe vetëreflektimi.

Identifikimi i faktorëve që kanë ndikim në qëndrimet e mësimdhënësve kosovarë ndaj edukimit gjithëpërfshirës, si dhe eksplorimi i sfidave e nevojave të tyre në këtë fushë, rezultojnë me zhvillimin e një modeli që adreson dhe mbështet nevojat e mësimdhënësve, e që ndikojnë drejtpërdrejt në politikën dhe praktikën më të mira gjithëpërfshirëse në arsimin parauniversitar në Kosovë.